

**ZYRA E KRYEPROKURORIT TË SHTETIT
TË KOSOVËS**

ZYRA E KRYEPROKURORIT TË EULEX-it

Prishtinë, 12 nëntor, 2013

Për: Të gjithë Kryeprokurorët e Prokurorive Themelore
Kryeprokurorin e Apelit
Gjithë Prokuratorët e Shtetit
Gjithë Prokuratorët e EULEX-it

UDHËZIME MBI MARRËVESHJET PËR PRANIMIN E FAJËSISË

Të nderuar,

Brenda dispozitave të kodit të procedurës penale (që këndej e tutje: KPP), që kanë hyrë në fuqi më 1 janar 2013,

Me qëllim të organizimit të aktiviteteve të të gjithë prokurorëve në lidhje me marrëveshjet për pranimin e fajësisë në formë të shkruar,

Ndaj, nëpërmjet kësaj si në vijim i nxjerrim

UDHËZIMET

- 1) Marrëveshja për pranimin e fajësisë duhet të i pasqyroj faktet e akuzave dhe kualifikimit ligjor të veprave për të cilat i pandehuri do e pranoj fajësinë. Gjithashtu është e mundur që të përmbyllt marrëveshja për pranimin e fajësisë vetëm për disa akuza.
- 2) Marrëveshja për pranimin e fajësisë mund të negociohet dhe arrihet në çdo kohë gjatë procedurës penale deri tek momenti i përfundimit të shqyrtimit gjyqësor.
- 3) Negociatat për pranimin e fajësisë nuk duhet të shihen, në asnjë moment, si një mënyrë e ujdisë për akuzat nëse ka dëshmi që do të shpien drejt ndjekjes penale të një individi për këto akuza¹ dhe as e nuk implikon ekzistimin e negociatave për akuzat gjatë hetimeve, as mundësinë që të huhen poshtë disa nga akuzat në këmbim të marrëveshjes së pranimit të fajësisë.
- 4) Marrëveshja për pranimin e fajësisë në formë të shkruar, nuk duhet të përbaj asnjë fjalë që mund të bëj prokurorin e shtetit të mos i filloj hetimet për ndonjë krim (ose të i hudh poshtë, ose të tërhiqet nga ndjekja penale) të cilat sipas ligjit në fuqi do të hetohen ose ndiqen penalisht sipas *detyrës zyrtare*.
- 5) Prokurori i shtetit i ka vetëm mundësitë vijuese që t'i ofroj të pandehurit, në këmbim të pranimit të fajësisë:
 - a) Sa i përket nenit 233, paragrafit 1, nën-paragrafit 1.1, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.1 dhe paragrafit 6 të KPP-së, rekomandimi për të pandehurin që të dënohet me një dënim shumë më të butë, por jo nën kufijtë e paraparë nga neni 76 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (që këtu e tutje KP RK) në fuqi që nga 1 janari, 2013; një rekomandim i tillë mund të kombinohet me një rekomandim tjetër i adresuar në gjykatë për të vendosur sipas nenit 75, paragrafit 1.3 të KK RK, që i lejon gjykatës të jap një dënim nën minimumin e paraparë nga neni 76 të KK RK, por vetëm deri në masën e lejuar me nenin 233, paragafin 7 të KPP-së).
 - b) Zbatimi sipas nenit 236 të KPP-së në gjykatë për të lëshuar një urdhër ku deklarohet që i pandehuri do jetë "një dëshmitar bashkëpunues", ashtu siç përkufizohet me nenin 235 të KPP-së.
 - c) Një rekomandim që ka të bëjë me lirimin e dënitit ashtu siç është paraparë me nenin 234 të KPP-së.
- 6) Marrëveshjet për pranimin e fajësisë në formë të shkruar në të shkruar duhet gjithmonë që të i specifikojnë "*Përgjegjësitet e të pandehurit për kompensimin që duhet t'ia bëjë palës së*

¹ Sipas parimeve të përbledhura në kapitullin VI dhe nenet 82, 102, 158, 240, 292 dhe 350 të KPP-së.

dëmtuar" (neni 233, paragrafi 12.4 i KPP-së), pavarësisht paraqitjes së kërkesës pasurore-juridike nga ana e palës së dëmtuar. Përgjegjësia e të pandehurit është diçka tjetër nga përcaktimi aktual i dëmit që pala e dëmtuar ka vuajtur, e cila mund të kërkohet gjithashtu edhe në procedurën civile.

- 7) Konfiskimi i që të dyave, edhe objekteve edhe përfitimeve materiale të krimit, do të merren parasysh gjatë të gjitha negociatave për pranim të fajësisë.

Prokurorët e shtetit duhet të sigurojnë që hetimet e domosdoshme janë bërë kundrejt objekteve të përdorura, të fituara ose të destinuara për përdorim në veprën penale, ashtu si dhe të gjitha përfitimet materiale të fituara nga kryerja e veprës penale (qoftë nga i pandehuri, palët e treta ose personat ligjor). Neni 233 paragrafi 12.4 i KPP-së kërkon në veçanti që marrëveshja për pranimin e fajësisë duhet të specifikoj "konfiskimin e të gjitha aseteve që janë subjekt i konfiskimit sipas kapitullit XVIII të KPP-së".

Nëse është e zbatueshme, prokurorët e shtetit do të i përfshijnë dispozitat në marrëveshjet e pranimit të fajësisë që kanë të bëjnë me konfiskimin e të dyave, objekteve dhe përfitimeve materiale të fituara nga kryerja e krimit dhe duhet të kërkojnë nga gjykata që të marrin parasysh marrëveshjen për pranimin e fajësisë për të urdhëruar konfiskimin e objekteve² dhe konfiskimin e përfitimeve materiale nga krimi³.

- 8) Në përputhshmëri me nenin 233 paragrafët 8, 9 dhe 12 i KPP-së gjatë procedurës për negocimin e marrëveshjes së pranimit të fajësisë, prokurori i shtetit do të parasheh një paragraf në të cilin i pandehuri (të pandehurit) pajtohet (n) për kompensimin e palës së dëmtuar me një shumë të caktuar aq sa janë dëmet e shkaktuara me kryerjen e veprës penale, përfshirë humbjen e përfitimit, dëmtimet morale dhe dëmtimet tjera jo-monetare, ose të rivendos në një mënyrë tjetër të drejtat e palës së dëmtuar (nëpërmjet p.sh. kthimit të objektit, etj.).

Prokurori i shtetit duhet të e dëgjoj palën e dëmtuar në përputhshmëri me rrethanat.

Përcaktimi i shumës ose modaliteteve tjera për të i rivendosur të drejtat e palës së dëmtuar, gjë e bërë nga prokurori i shtetit dhe i pandehuri, nuk do të kanë ndikim në të drejtat e palës së dëmtuar, nëse pajtueshmëria e arritur nuk është e mjaftueshme për rivendosjen e të drejtave të tij/saj.

- 9) Kryeprokurori i prokurorisë themelore përkatëse (Kryeprokurori i EULEX-it nëse prokurori është nga EULEX-i, ose që të dy nëse rasti është duke u ndjekur penalisht ose hetuar nga ekipet e përziera në kohën kur është arritur marrëveshja) nuk do autorizoj asnjë marrëveshje për pranim

² Përveç kapitullit XVIII të KPP-së shiko gjithashtu nenet 62 dhe 69 të KK RK. Shënim: veprat specifike penale të KK RK gjithashtu kërkojnë konfiskimin e sendeve të veçanta – p.sh. armëve ose drogës.

³ Përveç kapitullit XVIII të KPP-së shiko gjithashtu kapitullin VII të KK RK.


të fajësisë me të pandehurin, nëse i pandehuri nuk pranon kthimin e përfitimeve materiale nga një vepër penale ose të kompensoj ose rivendos palës së dëmtuar të drejtat, ose nëse marrëveshja për pranim të fajësisë është në ndonjë mënyrë tjetër në kundërshtim me dispozitat e ligjit në fuqi.


- 10) Një marrëveshje për pranimin e fajësisë në formë të shkruar, e miratuar nga kryeprokurori i prokurorisë kompetente themelore (ose kryeprokurorit të EULEX-it nëse është përmbyllur nga prokurorët e EULEX-it ose që të dy palëve në rastet kur rasti është hetuar ose ndjekur penalisht nga ekipet e përziera në kohën kur marrëveshja është bërë), mund të dorëzohet tek gjykata kompetente vetëm pasi të jetë nënshkruar nga i pandehuri. Nënshkrimet vetëm të avokatit të të pandehurit dhe prokurorit të shtetit në dokumentet përkatëse nuk janë të mjaftueshme për qëllime arkivimi.


Udhëzimet e mëtejme mund të lëshohen në fazat e mëvonshme. Mos-respektimi i këtyre udhëzimeve mund të konsiderohet si shkelje e rëndë e kodit të etikës për prokurorë.

Pritet nga të gjithë prokurorët e shtetit që të i respektojnë këto udhëzime; dështimi për të bërë këtë gjë do shpie në mos-autORIZIMIN e marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

Këto udhëzime të tanishme i mbizotërojnë udhëzimet e lëshuara më 16 gusht 2011 mbi marrëveshjet për pranimin e fajësisë, dhe hyjnë në fuqi menjëherë.


Kryeprokurori i Shtetit të Kosovës
Ismet Kabashi




Kryeprokurori i EULEX-it
Jaroslava Novotna